

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6233
E shtunë, 6 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Pas njohjes së Izraelit,
hyn në fuqi marrëveshja
për investime amerikane
në Kosovë | FAQE 5



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI | FAQE 4-5

PARTITË E TJERA PO KONFRONTOHEN MES VETE, S'PO PËRPIQËN TA NDALIN TRIUMFIN E LV-së



Analisti politik Shkelzen Maliqi ka vlerësuar se prej shpalljes së zgjedhjeve është vërejtur një siguri e sfocuar e Lëvizjes Vetëvendosje se do të fitojë bindshëm në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se për këtë arsyë ky subjekt politik këto zgjedhje po i quan referendum. Sipas Maliqit, partitë e tjera më shumë po konfrontohen mes vete

sesa që po përpiqen ta ndalin triumfin e LV-së. Maliqi ka bërë me dije se fituesi i këtyre zgjedhjeve do të ketë vështirë realizimin e premtiveve të mëdha që po i jep

MILIONA EURO PËR ZGJEDHJE TË "PANEVOJSHME"



Rreth 23.5 milionë euro i ka kushtuar buxhetit të Kosovës organizimi i pesë ciklevë të zgjedhjeve parlamentare në 11 vjetët e fundit, duke përfshirë edhe zgjedhjet që do të mbahen

më 14 shkurt. Në Kosovë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare u mbajtën në vitin 2010, 2014, 2017, 2019. Zgjedhjet e ardhshme pritet të mbahen javën tjetër

ATK-ja TEJKALON PLANIN E TË HYRAVE PËR MUAJIN JANAR, MBLEDH 4 MILIONË EURO MË SHUMË | FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRICESHA
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.pricesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 facebook.com Gazeta "Epoka e re"



OPINION

ZBUTJA E QËNDRIMEVE
TË ALBINIT MË NGJANË
ME ZBUTJEN E TARAKUT
TË HAJDINIT! F. 8

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



MARRËDHËNIET NË MES TË SHQIPËRISË DHE MAQEDONISË
SË VERIUT, SHTYLLË
E STABILITETIT RAJONAL F. 2

EDHE VOTUESIT NGA DIASPORA
QË NUK KANË PRANUAR
TELEFONATË NGA KQZ-ja
MUND TË VOTOJNË F. 3

EKONOMI



INDEKSI I ÇMIMEVE
TË PRODHIMEVE BLECTORALE
SHËNON RRITJE PËR
4.63 PËR QIND F. 9

30 GRA NË PRIZREN DO TË
PËRFITOJNË SUBVENCIONE
PËR BIZNESET E TYRE F. 9

Marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, shtyllë e stabilitetit rajonal

TIRANË, 5 SHKURT - Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka qëndruar të premtën përvizitë në Tiranë. Ai gjatë kësaj vizite është takuar me ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka. Kjo e fundit në një konferencë për media së bashku me

Osmanin, ka theksuar se viti 2021 është një vit vendimtar për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. "Me homologun Bujar Osmani ndamë në Tiranë të njëjtën qëndrim, se anëtarësimi në BE i mbarë rajonit, është garancia e zhvillimit të rajonit, por jo vetëm kaq, është edhe një

kontribut i madh për sigurinë e vet Bashkimit Evropian. Marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe MV janë shtyllë e stabilitetit rajonal. Krenar përfaktorin në Maqedoninë e Veriut që është një urë lidhëse mes vendeve tona dhe faktor stabiliteti në rajon”, ka thënë Xhaka.



Rusia dëbon diplomatët evropianë që “morën pjesë” në protestat për Navalnyn



Moskë, 5 shkurt - Rusia ka shpallur "persona non grata" (persona të padëshiruar) një numër të paspecifikuar të diplomatëve që punojnë në misionet diplomatike të Suedisë, Polonisë dhe Gjermanisë, duke thënë se ata kanë marrë pjesë në protestat që u organizuan në mbështetje të opozitarit rus, Aleksei Navalny. Ministria e Jashtme ruse tha më 5 shkurt se ambasadori suzed, i ngarkuari me punë i Polonisë dhe i dërguari gjerman, janë ftuar në ministri, për t'iu shprehur indinjata e Rusisë për piesëmarrien e diplomatëve në

protestat e 23 janarit. "Diplomatët që kanë marrë pjesë në veprime joligjore janë shpallur 'persona non grata' në përputhje me Konventën e Vjenës mbi marrëdhënet diplomatike të 18 prillit, 1961. Ata janë urdhëruar që në një të ardhme të afërt të largohen nga territori i Federatës ruse", tha ministria.

Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, i ka bërë thirrje Rusisë që ta rishqyrtojë vendimin për dëbimin e diplomatëve evropianë. "Edënoj fuqishëm këtë vendim dhe hedh poshtë pretendimet

për aktivitetet e tyre (diplomatëve) dhe i bëjë Rusisë që ta rishqyrtojë vendimin e saj, tha Borrell, njoftoi përmes "Twitter"-it, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Më 22-23 janar dhe më 31 janar, në Rusi dhjetëra-mijëra persona kanë protestuar për të kundërshtuar dënimin e Navalnyt, lidhur me një rast të mëparshëm për keqpërdorim fondesh. Navalny thotë se rasti ndaj tij është i motivuar politikisht. Ai është dënuar me tri vjet burgim.

Në këto protesta janë arrestuar mijëra persona.

Mali i Zi shfuqizon vendimin gjyqësor për “puçistët”

PODGORICE, 5 SHKURT - Gjykata e Apelit e Malit të Zi e ka shfuqizuar vendimin, me të cilin 13 persona të akuzuar për përpjekje për terrorizëm, në ditën e zgjedhjeve parlamentare në vitin 2016, ishin dënuar me gati 70 vjet burg.

Gjykata e Apelit pranoi ankesat e avokatëve mbrojtës të të dënuarve në shkallën e parë me akt gjykimin e Gjykatës së Lartë në Podgoricë, i cili u shqiptua më 9 maj të vitit 2019. Procedimet u rikthyen në Gjykatën e Lartë por, siç thuhet në vendim, ato u rikthyen “përpara një dhoma gjyqi të ndryshuar plotësisht”

Në mesin e tyre janë edhe shtetasit rusë Eduard Shishmakov dhe Vladimir

Popov, të cilët u akuzuan se kanë bërë vepër penale të terrorizmit në tentim dhe ishin dënuar në shkallën e parë me 15 dhe 12 vjet burg.

Lideri i Frontit Demokratik (DF), Millan Knezheviq dhe Andrija Mandiq, ishin të dënuar me nga 5 vjet burg nën akuzën pér krijimin e

organizatës kriminale. Aktgjyki mi është shfuqizuar edhe për shtetasit serbë të akuzuar: gjenerali i pensionuar i xhandarmërisë së Serbisë, Bratisllav Dikiq, i cili u dënuar me 8 vjet burgim, si dhe për akuzuarit: Predrag Bogiqeviq, Nemjanja Ristiq, Kristina Hristiq, Branka Milliq, Millan Dushica, Dragan Maksiq, Sërbolub Gjorgjeviq dhe artistin e Frontit Demokratik



Mihail Çagjenoviç.
Gjykata e Apelit urdhëroi që
Bratisllav Dikiqit t'i hiqet
paraburgimi dhe ai të lirohet
menjëherë. Të tjerët të dënuar
nga Gjykata e Lartë u liruan më
herët ose ishin të paarritshëm
nër gjyqësorin e Malit të Zi

Tentimi për të bërë "grusht shteti" në Mal të Zi ka ndodhur në ditën e zgjedhjeve parlamentare, në nëntor të vitit 2016, kur shërbimet malazeze të sigurisë arrestuan disa dhjetëra shtetas të Serbisë të cilët dyshoheshin

për përpjekje për të kryer aksione terroriste, në mënyrë që të përbysnin qeverinë me një ndërhyrje të dhunshme në Parlamentin e Malit të Zi dhe për kapjen ose likuidimin e kryeministrat të atëhershëm, Millo Giukanovic.



Gjermania mirëpret vendimin e ShBA-së për mostërheqjen e trupave

BERLIN, 5 SHKURT - Qeveria gjermane të premten mirëpriti vendimin e presidentit amerikan Joe Biden, që edhe zyrtarisht ta ndalë tërheqjen e paraparë të trupave amerikane

nga Gjermania, duke thënë se vendosja e këtyre trupave në shtetin gjerman “është në interesin tonë të përbashkët”. Vitin e kaluar, atëbotë presidenti amerikan Donald

Trump, njoftoi se do të tërheqë rrëth 9 500 trupa amerikane nga 34 500 sa janë gjithsej në Gjermani, por tërheqja e tyre nuk ndodhi asnjëherë. Më 4 shkurt Bideni tha se plani për

térheqjen e trupave do të ndalohej derisa sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, ta rishikonte praninë e trupave amerikane në mbarë botën.

Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e radhës

Daka: Ka tri javë që jam bërë personaliteti më i urryer

Kryetarja e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije se në tri javët e fundit është bërë personi më i urryer në vend. Ajo ka treguar se në këtë drejtim kanë kontribuuar disa personalitete, por nuk ka përmendur emrat se kush janë ata. Në mbledhjen e së premtes, KQZ-ja ka hedhur poshtë pretendimet se ka organizuar sondazh për zgjedhjet e 14 shkurtit

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryetarja e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka deklaruar se kohën e fundit është bërë shumë presion ndaj saj. Në mbledhjen e KQZ-së të mbajtur të premten, ajo ka thënë se është bërë personi më i urryer në vend në tri javët e fundit nga disa persona. "Jam bërë personi më i urryer në tri javët e fundit nga disa personalitete të cilat nuk do t'i tregojë me emër", ka thënë Daka.

E para e KQZ-së edhe në këtë

mbledhje ka pasur përplasje me anëtarin e LV-së në KQZ, Sami Kurteshi, rrëth pranimit të votave nga diaspora. Anëtar i LV-së ka thënë se votat nga diaspora duhet të pranojen deri një ditë para zgjedhjeve, pra deri më 13 shkurt. "Me këtë ne ua vjedhim disa orë njerëzve, po e kufizojmë një të drejtë të njerëzve për disa orë. Aktgjykim i Kushtetueses e caktion 24-orëshin. E kundërligjshme është data 12, ora 24.00. Unë po kërkoj që data e fundit kur mund të pranojen pakot me fletëvotime të jetë data 13 shkurt, ora 12.00", ka thënë Kurteshi. Me këtë qëndrim të

Kurteshit nuk janë pajtuar anëtarët e tjeter të KQZ-së, të cilët, në shenjë mospajtimi, e kanë lëshuar mbledhjen e KQZ-së.

KQZ-ja: Nuk kemi organizuar asnje sondazh

Në mbledhjen e së premtes, Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve është distancuar nga publikimi në medie i një sondazhi për rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit për të cilin është raportuar se është bërë nga KQZ-ja. Këtë çështje në mbledhje e ka ngritur Arianit Elshani, anëtar i KQZ-së nga radhët e PDK-së, i cili ka kërkuar që këto sondazhe të demantohen. Më pas, edhe kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka kërkuar që ky lajm të demantohet me një deklaratë për media. "Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve njofton se janë të pavërteta sondazhet të cilat po qarkullojnë nëpër rrjete sociale si të organizuara nga KQZ-ja. Nuk është aspak e vërtetë që KQZ-ja ka organizuar ndonjë sondazh të

çfarëdo natyre. Gjithashtu, u bëjmë thirrje qytetarëve që të mos jasin të dhënë ato të tyre që u

kërkohen, sepse ato mund të keqpërdoren", është thënë në deklaratën përmes të KQZ-së.

Edhe votuesit nga diaspora që nuk kanë pranuar telefonatë nga KQZ-ja mund të votojnë

Shumë qytetarë të Kosovës të cilët jetojnë në diasporë janë ankuar në lidhje me çështjen e votimit për zgjedhjet e 14 shkurtit. Në lidhje me këto shqetësimë, zëdhënësi i Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije për "Epokën e re" se ky komision nuk ka arritur t'i kontaktojë përmes telefonit të gjithë votuesit nga diaspora. Elezi ka thënë se çdo votues që i ka plotësuar kushtet ligjore do të mund të votojnë edhe pse

KQZ-ja nuk e ka kontaktuar përmes telefonit. "KQZ-ja ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve, përfshirë edhe votuesit jashtë vendit. Sipas kësaj liste, janë 102 mijë e 100 votues të cilët janë aprovuar nga KQZ-ja pasi kanë plotësuar kriteret e zotësisë juridike. Në mesin e këtyre votuesve janë përfshirë edhe aplikuesit të cilët ne nuk kemi arritur t'i kontaktojmë përmes telefonit apo që nuk janë lajmëruar në telefon", ka thënë Elezi.



Pesë të vdekur dhe 284 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 951 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 284 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Dragash një rast (81 vjeç), Mitrovicë një rast (73 vjeç), Obiliq një rast (86 vjeç), Pejë një rast (83 vjeç) dhe Podujevë një rast (67 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 61 688 raste nga 244 950 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 1 519 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 224 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 53 455 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 714.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 112 raste, Pejë 29 raste, Prizren 21 raste, Ferizaj 19 raste, Gjakovë 12 raste, Fushë-Kosovë 10 raste, Gjilan 10 raste, Mitrovicë 10 raste, Podujevë 10 raste, Suharekë 8 raste, Deçan 6 raste, Kaçanik 5 raste, Vushtrri 5 raste, Istog 4 raste, Lipjan 4 raste, Kamenicë 3 raste, Klinë 3 raste, Rahovec 3 raste, Drenas 2 raste, Mamushë 2 raste dhe nga një rast komunat Graçanicë, Junik, Malishevë, Obiliq, Skenderaj dhe Viti.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

Partitë e tjera po konfrontohen mes vete, s'po përpinqen ta ndalin triumfin e LV-së

Analisti politik Shkëlzen Malqi ka vlerësuar se prej shpalljes së zgjedhjeve është vërejtur një siguri e sforuar e Lëvizjes Vetëvendosje se do të fitojë bindshëm në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se për këtë arsyë ky subjekt politik këto zgjedhje po i quan referendum. Sipas Maliqit, partitë e tjera më shumë po konfrontohen mes vete sesa që po përpinqen ta ndalin triumfin e LV-së. Malqi ka bërë me dije se fituesi i këtyre zgjedhjeve do të ketë vështirë realizimin e premtimeve të mëdha që po i jep

**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 SHKURT - Analisti politik Shkëlzen Malqi ka komentuar aktivitetet e deritashme të partive politike. Ai ka deklaruar se prej shpalljes së zgjedhjeve është vërejtur një siguri e sforuar e Lëvizjes

Vetëvendosje se do të fitojë bindshëm në zgjedhjet e 14 shkurtit.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se partitë e tjera më shumë po konfrontohen mes vete sesa që po përpinqen ta ndalin triumfin e LV-së. "Ajo çka po ndodh prej se më në fund u

shpallën zgjedhjet e jashtëzakonshme, tregon një siguri të sforuar të Lëvizjes Vetëvendosje se do t'i fitojë bindshëm zgjedhjet, të cilat po i quan referendum, kundrejt pasigurisë të partive të tjera që më shumë konfrontohen mes vete sesa që përpinqen ta ndalin triumfin e LV-së", ka thënë Malqi.

Ai ka mbrojtur sondazhin e "Qendrës Gani Bobi", i cili LV-në e nxjerr fituese të zgjedhjeve të 14 shkurtit. "Unë jam kyçur edhe vetë me një sondazh në javën e fundit të janarit me ekipin e 'Qendrës Gani Bobi' dhe mund të thirrem në rezultatet që i kemi publikuar të martën në portalin e ri 'Albanian Post' si burim i besueshëm për epilogun e 14 shkurtit. Sipas këtij sondazhi, Lëvizja Vetëvendosje ka përparësi bindëse, 51,3 për qind

të të anketuarve do të votojnë për këtë subjekt. Subjektet rivale, qoftë nëse garojnë vetëm ose në koalicionë, do ta kenë përkrahjen dukshëm më të ulët. Votën pro LDK-së e kanë deklaruar 15.5 për qind, pro PDK-së 13.2 për qind dhe pro AAK-së 5.5 për qind të të anketuarve", ka thënë ai.

Malqi ka bërë me dije se fituesi i këtyre zgjedhjeve do të ketë vështirë realizimin e premtimeve të mëdha. "Unë e kam përshtypjen se premtimet e mëdha që po i japin fituesit e parapaguar, që thonë se gara zhvillohet vetëm për vendin e dytë, kurse fituesi dihet, nuk do ta kenë lehtë t'i realizojnë premtimet, sidomos ato që kanë të bëjnë me dialogun dhe marrëveshjen finale që do ta sigurojnë njohjen e ndërsjellë dhe ulëse për Kosovën në OKB", ka deklaruar ai.

Ndër të tjera, ai ka komentuar edhe diskursin politik të partive politike gjatë parafushatës. "Në frontin tjetër, gjuha edhe më e ashpër dégjohet në konfrontimin rreth kontingjentit të votave në favor të luftës çlirimtare për të cilën në garë janë PDK-ja, Nisma dhe AAK-ja. Akuzat e ndërsjella dhe gjuha denigruese në vend të bashkëpunimit, në përgjithësi ka efekt kundërproduktiv, sidomos të votuesit e ri", ka deklaruar Malqi.

"Epoka e re": Z. Malqi, megjithëse zyrtarisht fushata zgjedhore ka filluar të martën, partitë politike kanë zhvilluar aktivitete elektorale që një kohë. Si i keni parë këto aktivitete të tyre?

Malqi: Intensiteti i fushatës nuk ka qenë sikur për zgjedhjet e rregullta, jo vetëm për shkak

të pandemisë, por edhe përfaktin se krejt çfarë ka ndodhur në politikën e Kosovës gjatë një viti ka qenë e lidhur me përsëritjen e zgjedhjeve, pra një fushatë e zgjatur. Ajo çfarë po ndodh prej se më në fund u shpallën zgjedhjet e jashtëzakonshme, tregon siguri të sforuar të Lëvizjes Vetëvendosje se do t'i fitojë bindshëm zgjedhjet, të cilat po i quan referendum, kundrejt pasigurisë të partive tjera që më shumë konfrontohen mes vete sesa që përpilen ta ndalin triumfin e LV-së.

"Epoka e re": *Parafushata është karakterizuar edhe me gjuhë denigruese të partive politike ndaj konkurrenteve të tyre politikë. Cilat janë pritet tuaja përkëtë fushatë? Partitë, do ta ashperrojnë diskursin politik?*

Maliqi: Po, janë, të them ashtu, dy fronte konfrontimesh me gjuhë të ashpersuar. Nga njëra anë LDK-ja i ka edhe më tej hesapet e papastruara me LV-në, pasi që saga e "qeverisë së shpresës" e vitit 2019 përfundoi turpshëm dhe shkaktoi

largimin e Vjosa Osmanit në listën e LV-së. Osman, si duket, ka gjasa që t'i shkëputë shumë vota LDK-së. As leksioni i Podujevës, ku në zgjedhjet lokale LDK-ja humbi bindshëm bastionin e vet më të madh, nuk u kuptua seriozisht nga Isa Mustafa dhe garda e vjetër e LDK-së, që t'i jepin më shumë hapësirë si dhe drejtimin e partisë asaj vale të re të politikanëve që i mbeten luajalë LDK-së, dhe që do ta mund ta ndalte rrjedhjen e madhe të votës që tërheq Vjosa Osman. Në frontin tjetër, gjuha edhe më e ashper dëgjohet në konfrontimin rreth kontingjentit të votave në favor të luftës clirimtare për të cilën në garë janë PDK-ja, Nisma dhe AAK-ja. Akuzat e ndërsjella dhe gjuha denigruese më vend të bashkëpunimit, në përgjithësi, ka efekt kundërproduktiv, sidomos te votuesit e rinj.

"Epoka e re": *Deri më tanë janë publikuar shumë sondazhe që tregojnë përfundat e 14 shkurtit. Cilat janë*

parashikimet tuaja për 14 shkurt?

Maliqi: Unë jam kyçur edhe vetë me një sondazh në javën e fundit të janarit me ekipin e "Qendrës Gani Bobi" dhe mund të thirrem në rezultatet që i kemi publikuar të martën në portalin e ri "Albanian Post" si burim i besueshëm përi epilogun e 14 shkurtit. Sipas këtij sondazhi, Lëvizja Vetëvendosje! ka përparësi bindëse, 51,3 përfundat e 14 shkurtit. Momenti tjetër kritik për të gjitha anketat edhe të agjencive më të njohura dhe më profesionale botërore, është prirja e disa kategorive të respondentëve që ta fshehin votën e tyre nga arsyet e paparashikueshme.

"Epoka e re": *Kosovën e presin shumë sfida. A mendoni se këto zgjedhje do të sjellin zgjedhje për Kosovën?*

Maliqi: Vetëm pasi që të numërohen votat do të mund të bëhen analizat më të sakta se a do të sjellin këto zgjedhje, zgjedhjen e problemeve që i ka Kosova. Unë e kam përshtypjen se premtimet e mëdha që po i jepin fituesit e

janë dy elemente shtesë përsprovë më 14 shkurt që edhe vota reale të jetë siç e kanë deklaruar të anketuarit. Çdo anketë i ka momentet e të panjohurës që mund ta kushtëzojnë huqjen, nëse kemi gabuar ne në projektimin e saktë të mostrës, sepse nuk duhet harruar se kemi përzgjedhur 1 030 respondentë që të flasin në emër të një milion votuesve. Momenti tjetër kritik për të gjitha anketat edhe të agjencive më të njohura dhe më profesionale botërore, është prirja e disa kategorive të respondentëve që ta fshehin votën e tyre nga arsyet e paparashikueshme.

"Epoka e re": *Kosovën e presin shumë sfida. A mendoni se këto zgjedhje do të sjellin zgjedhje për Kosovën?*

Maliqi: Vetëm pasi që të numërohen votat do të mund të bëhen analizat më të sakta se a do të sjellin këto zgjedhje, zgjedhjen e problemeve që i ka Kosova. Unë e kam përshtypjen se premtimet e mëdha që po i jepin fituesit e

parapaguar, që thonë se gara zhvillohet vetëm përvendin e dytë, kurse fituesi dihet, nuk do ta kenë lehtë t'i realizojnë premtimet, sidomos ato që kanë të bëjnë me dialogun dhe marrëveshjen finale që do ta sigurojnë njohjen e ndërsjellë dhe ulëse për Kosovën në OKB.

"Epoka e re": *Në këto zgjedhje, përvëç kandidatëve përkryeministër, kemi edhe kandidatë për president. Besoni se legjislatura që do të dalë përfundit këtyre zgjedhjeve do të mund ta zgjedhë edhe presidentin?*

Maliqi: Zgjedhjet janë përvendin dhe përvendetët. Kuvendi besoj se do ta ketë kapacitetin që ta zgjedhë kryeministrin, por meqë nuk e kemi presidentin me kapacitet të plotë dhe po përfundon periudha e zëvendëspresidentes, ky Kuvend duhet ta zgjedhë edhe presidentin e ri, e që nuk mund ta dimë a do të jetë e mundshme. Nëse jo, do të kemi edhe një cikël zgjedhjesh gjatë verës ose në vjeshtë.

Pas njohjes së Izraelit, hyn në fuqi marrëveshja përinvestime amerikane në Kosovë



PRISHTINË, 5 SHKURT - Përvëç njohjes nga Izraeli dhe vendosjes së raporteve diplomatike me këtë shtet, Kosovës i ka ardhur edhe një lajm i mirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që është derivat i marrëveshjes së 4 shtatorit të nënshkruar nga Avdullah Hoti dhe Donald

Trump në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë. Tashmë ka hyrë në fuqi marrëveshja përinvestime nxitëse e Korporatës Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (DFC), e cila është edhe pjesë e marrëveshjes së 4 shtatorit. Këtë e ka bërë më dije vetë DFC

përmes një njoftimi zyrtar në "Twitter", i cili është rishpërndarë edhe nga faqja e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë. "Marrëveshja e re e DFC-së përinvestime nxitëse ka hyrë në fuqi, duke ia mundësuar DFC-së vendosjen e serisë së plotë të produkteve financiare në

Kosovë", është bërë me dije në faqen zyrtare të DFC-së në "Twitter".

Nga zyra e Departamentit të Shtetit në Evropë kjo marrëveshje po cilësohet si forcim i mbështetjes së ShBA-së për zhvillimin e ekonomisë së Kosovë me krijimin e vendeve të

reja të punës dhe rritjen e investimeve. "Njoftimi i sotëm forcon angazhimin e ShBA-së për ta mbështetur zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. IIA e DFC-së me Kosovën do të ndihmojë në mobilizimin e investimeve që krijojnë vende pune", është thënë në reagim.

Milionë euro për zgjedhje të "panevojshme"



PRISHTINË, 5 SHKURT - Rreth 23.5 milionë euro i ka kushtuar buxhetit të Kosovës organizimi i pesë cikleve të zgjedhjeve parlamentare në 11 vjetët e fundit, duke përfshirë edhe zgjedhjet që do të mbahen më 14 shkurt. Në Kosovë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare u mbajtën në vitin 2010, 2014, 2017, 2019 dhe zgjedhjet e ardhshme pritet të mbahen javën tjetër.

Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të mbajtura në vitin 2010, buxhetit të Kosovës, sipas të dhënavë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i kanë kushtuar 4.5 milionë euro, ndërkakq për zgjedhjet që pritet të mbahen më 14 shkurt, qeveria në detyrë ka ndarë 5.5 milionë euro.

Që nga zgjedhjet e vitit 2010, kur kryeministër ishte zgjedhur Hashim Thaçi dhe ka përfunduar mandatin katërvjeçar, asnjë qeveri tjetër nuk ka arritur të përfundojë mandatin kushtetues, e që si pasojë ka imponuar organizimin e zgjedhjeve të parakohshme.

Mjetet e shpenzuara për zgjedhje të parakohshme rëndojnë buxhetin e Kosovës, i cili kap shifren në 2.4 miliardë euro, thotë profesori i Ekonomisë, Musa Limani dhe ish-drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gérxhaliu. Ata

vlerësojnë se gjendja ekonomike në vend nuk është e leverdishme për zgjedhje të jashtëzakonshme.

Limani: Buxheti do të kursente mbi 10 milionë euro

Musa Limani, profesor i Ekonomisë, thotë se zgjedhjet e shpeshta absorbojnë vlera të mëdha materiale të tatimpaguesve. Nëse zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, thotë Limani, do të mbahen në bazë të procedurave ligjore, çdo katër vjet, buxhetit do t'i kishin kursyer mbi dhjetë milionë euro. Dhe këto mjete do të mund të shfrytëzoheshim për krijimin e vendeve të punës. "Nëse e shohim nga efikasiteti i këtyre mjeteve, me këto mjete do të mund të hapen shumë vende të reja të punës. Nëse llogarisim se krijimi i një vendi pune kushton 10 mijë, atëherë del numër jashtëzakonisht i madh i vendeve të punës. Në këtë mënyrë ishte zgjedhjeve shkalla e papunësisë, rrjedhimisht ulja e problemeve sociale", thekson Limani.

Shkalla e papunësisë, sipas të dhënavë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është rrreth 30 për qind, kurse mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Vetëm për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, sipas Odës Ekonomike të Kosovës dhe asaj të afarizmit, deri në 30 mijë të punësuar gjatë pandemisë mund të kenë humbur vendin e punës. Lidhur me këtë shifrat zyrtare mungojnë.

Në anën vjetër, personat që punojnë në sektorin publik marrin pagë mesatare deri në 500 euro, kurse ata në sektorin privat rrreth 350 euro.

Gérxhaliu: Shpenzimet për zgjedhje janë të pallogaritshme

Safet Gérxhaliu, ish-drejtor në Odën Ekonomike të Kosovës, e konsideron të panevojshëm dhe me ndikime buxhetore organizimin e shpeshtë të zgjedhjeve. Ai thotë se, përveç informatave zyrtare për shpenzimet e KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve, nuk ka ndonjë përllogaritje të saktë për shpenzimet që bëjnë partitë politike. Ciklet e shpeshta zgjedhore, sipas tij, Kosovën e kanë shndërruar në hapësirë eksperimentale politike, ku gjithsecila parti lufton për pushtet dhe jo përshtet. "Informatat për shpenzime në zgjedhje merren vetëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por anashkalohen

kostot e tjera që përcjellin procesin zgjedhor. Besoni se në biseda me ish-deputetë të Kuvendit të Kosovës, llogaritet që në fushatë zgjedhore çdo njëri prej tyre shpenzon nga 10 deri në 20 mijë (euro). E tërë kjo e ngritë koston. Dhe, Kosova nuk duhet që të lejojë një eksperiment të tillë", thekson Gérxhaliu.

Ndërkaq, profesori Limani thekson se tashmë kur Kosova ka pësuar humbje të mëdha financiare për shkak të pandemisë, mjetet e nevojshme për organizim të zgjedhjeve, kanë mundur të orientohen në sektorë të goditur më shumë nga Covid-19. "Këto mjete që shpenzohen për zgjedhje të jashtëzakonshme, ka qenë shumë më efikase, shumë më e drejtë, shumë më humane që t'i jepen sektorit privat dhe t'i mundësohet ta mbajë prodhimin në kompanitë e tyre dhe mos të krijojnë probleme sociale", thekson Limani. Sipas tij, buxheti i zgjedhjeve është i ndërtuar në shumë më pak se 200 milionë euro, që do të jetë më pak se 10% e buxhetit të Kuvendit të Kosovës (ATK), mbi 2000 milionë euro. "Kosova duhet të ketë një qeveri stabile, e cilët do të jetë më funksion të buxhetit dhe jo gjithmonë më demë të buxhetit. Kosova ka nevoja të shumta për investime. Sektori privat është i anashkaluar, projektet me prioritet janë vetëm ato ku përfiton politika", shprehet Gérxhaliu.

Përveç shumës mbi pesë milionë euro që ndahen nga buxheti i Kosovës për organizimin e zgjedhjeve, në vit, partive politike, të cilat janë të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, po nga buxheti i shtetit u ndahen më shumë se 4 milionë euro. Kurse gjatë periudhës shkurt - tetor, të vitit të kaluar, sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, janë mbyllur 761 biznese, të cilat kanë pasur të punësuar 1 316 punëtorë. Për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve, në kuadër të Ligjit përimëkëmbje ekonomike, Qeveria në detyrë e Kosovës, ka ndarë 222 milionë euro. Por, në kuadër të kësaj vlere është përfshirë edhe sektori i shëndetësisë, rritja e skemave sociale dhe pensioneve. Përkëtë arsy, Oda Ekonomike e Kosovës e ka quajtur vlerë të pamjaftueshme krasuar me nevojat e bizneseve. Kurse Safet Gérxhaliu konsideron se duhet të ndërpritet procesi i organizimit të shpeshtë të zgjedhjeve parlamentare, sepse në Kosovë nevojat janë të mëdha për investime. "Kosova duhet të ketë një qeveri stabile, e cilët do të jetë më funksion të buxhetit dhe jo gjithmonë më demë të buxhetit. Kosova ka nevoja të shumta për investime. Sektori privat është i anashkaluar, projektet me prioritet janë vetëm ato ku përfiton politika", shprehet Gérxhaliu.

Përveç shumës mbi pesë milionë euro që ndahen nga buxheti i Kosovës për organizimin e zgjedhjeve, në vit, partive politike, të cilat janë të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, po nga buxheti i shtetit u ndahen më shumë se 4 milionë euro.

Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

Kurti dhe Osmani priten me picë në Obiliq

OBILIQ, 5 SHKURT - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, bashkë me Vjosa Osmani, ushtruese e detyrës e presidentes, kanë vizituar të premten qytetin e Obiliqit dhe të Vushtrrisë. Ata u priten nga një numër i madh i qytetarëve, njëri prej të cilëve i shërbeu me picë Kurtin dhe Osmanin. Kurti ka bërë thirrje që të dalin sa më shumë persona për të votuar në zgjedhjet e 14 shkurtit. "Ne do të bëjmë referendum gjithëpopullor. Para 30 vjetëve populli kishte nënshkruar referendum për liri, edhe në vitin 2021 duhet të bëjmë referendum dhe duhet të deklarohemi për ndryshime demokratike që sjellin punësim dhe drejtësi. Fitorja e madhe do të jetë një ndryshim përfshirë gjithë juve pa diskriminuar asnjë njeri. Ne jemi të parët sepse nuk ka kush të dalë tjetër", ka thënë Kurti. Ndërsa Osmani ka deklaruar se më 14 shkurt nuk mund të ndalet vullneti për ndryshim.

janë rreshtuar krah kauzës "Me Çlirimtarët" përfshirë zgjedhjet e 14 shkurtit. "Kauza jonë 'Me Çlirimtarët' po bashkon patriotë të shumtë anekënd vendit, të cilët çdo ditë e më shumë po e mbështesin fryshtën çlirimtarë të Nismës dhe numrin 121", ka thënë Limaj, i cili ka bërë fushatë edhe në Marali dhe Dragobil të Malishevës. "U jemi mirënjohës dhe falënderues bashkëluftëtarëve dhe mbështetësve tanë të rinj në Marali dhe Dragobil, përmikpritjen që na bënë mbrëmë, si dhe përgatishmërinë e tyre përfshirë zgjedhjet e 14 shkurtit", ka thënë Limaj.

Hoti: E menaxhuam pandeminë dhe ndalëm abuzimet e blerjes së maskave shtatë euro

Prizren, 5 shkurt - Gjatë një takimi me qytetarë në Zhur të Prizrenit, kandidati i Lidhjes



sistemin tonë shëndetësor, kemi krijuar shtretër në të gjitha spitalet regionale, kemi integruar komunat dhe qendrat e mjekësisë familjare, kujdesin përpacientë nëpër shtëpi, blerjen e aparaturave shtesë përfshirë testime, blerjen e maskave, jo nga 7 euro, por nga 0.38 centë", tha kryeministri Hoti.

zgjerohet në të gjitha komunat. "Gjakova dhe Rahoveci tashmë kanë vendosur se kujt do t'i jasin besimin më 14 shkurt. Plani i Rimëkëmbjes po zgjerohet në të gjitha komunat e Kosovës dhe pas 14 shkurtit ky plan do të realizohet", ka thënë ai. Hoxhaj pas Gjakovës dhe Rahovecit ka zhvilluar aktivitet zgjedhor edhe në Deçan. Ai ka

kërkesave të kohës dhe të qytetarëve. Rimëkëmbje përfshirë Isniqin dhe Deçanin. Rimëkëmbje përfshirë Kosovën", ka deklaruar Hoxhaj.

Haradinaj premtion ringjallje të shpejtë të ekonomisë



Hoxhaj: Plani i rimëkëmbjes po zgjerohet në të gjitha komunat

Gjakovë, 5 shkurt - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat përkryeministër, Enver Hoxhaj, ka thënë se plani i rimëkëmbjes po

bërë thirrje që të votohet PDK-ja më 14 shkurt. "Bukuritë natyrore dhe potenciali i Jashtëzakonshëm turistik janë shanse të pashtfrytëzuara që e zhvillojnë Deçanin dhe fshatrat e tij. Dje në Isniq të Deçanit premtova dyfishim të investimeve në bujqësi e agrobiznes dhe investime në turizmin malor. Askush më mirë se PDK-ja nuk u përgjigjet



Limaj merr përkrahje në Vushtrri përfshirë Nismën

Malishevë, 5 shkurt - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vazhduar aktivitetin zgjedhor në Vushtrri dhe Malishevë. Limaj ka thënë se i është përgjigjur ftesës përbashkëbisedim me veteranët e UÇK-së nga Komuna e Vushtrrisë, familjarët e dëshmorëve dhe invalidët e luftës, të cilët, sipas tij, fuqishëm

Demokratike të Kosovës (LDK) përkryeministër, Avdullah Hoti, ka thënë të premten se qeveria e tij e ka menaxhuar me sukses pandeminë dhe ka ndalur abuzimet e blerjes së maskave nga 7 euro nga qeveria e mëparshme. "Kur e morëm në qershor detyrën kishte pesë muaj që kishte filluar pandemia. Nga shkurti deri në qershor nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim përtëmenaxhuar pandeminë dhe përtëruajtur ekonominë, me përjashtim të ndalimit të qarkullimit. E riorganizuan



Zbutja e qëndrimeve të Albinit më ngjanë me zbutjen e tarakut të Hajdinit!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Murroi i Hajdinit: Jam nip i Menxhiqëve nga fshati Lupç i Epërm. Fshat që, bashkë me fshatin Popovë, janë në vijën kufitare që e ndanë Llapin me Bajgorën. Fshati Lupç i Epërm ka pasur trima që kanë luftuar kundër turkut, bullgarit dhe serbit. Ia kanë kthyer pushkën çdo okupatori sikur që ka qenë bazë e sigurt për çetat kaçake dhe luftëtarët e lirisë si pas Luftës së Dytë Botërore ashtu edhe në luftën e së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Gjyshe kam pasur Hajdar Menxhiqin që ka jetuar 107 vjet dhe që është kujdesur përmua gjatë pushimeve verore që i kaloja në fshat. Madje, kur jam dënuar 12 vjet në Gjyqin Ushtarak në Zagreb, në gjykatore ka qenë edhe babagjyshi, me plis të bardhë në kokë e që nuk kuptonte gjuhën serbe. Më duket se për herë të parë dhe të fundit ka qenë atëherë në Zagreb. Daja Faik ka qenë si kreshnik i gojëdhënavë, një burrë mustaqemadh, me plis dhe maramë, i gjatë dhe i drejtë si qiri, por ishte edhe i drejtë në jetën e përditshme. Realisht, pushimet e verës i kaloja te dajat, në Lupç të Epërm dhe, pas një kohe, u ambientova dhe i bëja të gjitha punët që i bënin moshatarët, përashtuar këtu shatin dhe kosën. Nuk më ecnin. Të shkoje prej Podujeve në Lupç të Epërm ishte përjetim përmua, kurse fëmijët e fshatit mblidheshin ta shihnin se ka ardhur "shehërlia" e që nuk dalloja fare nga ta, isha edhe unë një qurravec dhe, në fillim, më shumë fitoja dajak nga çobanët e fshatit, derisa i përvetësova rregullat e të "mbijetuarit në kushte ekstreme". Shkoja në fshat me japanka të prodhimit kinez, që ngjanin me allstarkat e sotme dhe, në fund, kur vinte koha të kthehesha, i ndërroja me një palë opinga. I doja opingat në atë kohë. U bëra disi si një bari profesionist sepse shumicën e kohës i ruanim bagëtinë,

kryesish lopë, buallica, dele dhe, që nuk donim fare, kishim edhe do dhi të kuqe të cilat ka qenë vështirë i menaxhonim. Terreni ku dërgonim bagëtinë ishte disa kilometra larg fshatit, deri në Kunevik apo te Lagjja e Bajçinovcëve. Iknim herët në mëngjes dhe ktheheshim vonë në mbrëmje. Kohën kur ishte dreka, në mungesë të orës e matnim me shputa të këmbës dhe hijen e trupit. Mëngjesin e merrnim me vete dhe e hanim rrugës, kurse drekën na e sillnin disa çobanë që shkonin në fshat për ushqime. Për ujë nuk kishim fare problem sepse, ose kishte përrroska në mal, ose i hapnim vetë burimet dhe, pasi i linim të kulloeshin, e pinim ujin shumë të pastër. Në atë kohë kur shkoja te dajat mblidheshin fëmijët dhe kërkonin t'iu tregojë ndodhitë në qytet, për Tarzanin, majmunin Qita dhe filmat e tjerë. Si kryepersonazh, e kisha imagjinatën e zhvilluar duke ua krijuar situatat sikur në studiot e Paramounthit. Iu flisja për Akilin, Hektorin, Odisenë dhe Herkulin dhe, pas kësaj, të gjithë i prekним muskujt e duarve, të barkut dhe këmbëve. Unë, disi si Xhingis Kani dhe Hanibali që si mjet transporti dhe mjet lufte i përdorin elefantët, si mjet transporti i përdorja buajt dhe buallicat. U shtrija në shpinën e tyre të gjerë dhe bëja shtatë palë qejfe derisa mbërrinim te kullosat e Kunevikut apo livadhet e Bajçinovcëve. Fort i patëm dëmtuar livadhet e Bajçinovcëve, dardhat dhe qershët e tyre prandaj, nga një distancë e madhe kohore, si formë kompensimi për Bajçinovcët, i pata siguruar do vota Mefail Bajçinovcit në zgjedhjet e fundit.

Karvanit të gjatë të bagëtive të fshatit Lupç i Epërm i printe një dem murroi, sikur demat mitologjik duke krijuar siguri, si për bagëtinë ashtu edhe për neve, çobanët përfaktin se të gjithë shkonim pas tij, sikur pas liderit suprem. Ishte i mirënjohnur kau murroi i Hajdinit. Punët shkuant mirë deri në kohën kur murroi i Hajdinit bëri një lëvizje, nga pozita e liderit, kaloi në prapavijë. Mbeti i fundit. E arsyetuam duke ia dhënë, edhe në këtë pozitë rolin mbrojtës, por u bindëm se e kishte pasur me hile. Me rritjen e sasisë së testosteronit, ndryshoi

edhe roli dhe misioni i murroit të Hajdinit. Tash, filloi t'i kërcente, fillimisht lopëve të fshatit (i ruante të familjes), pastaj edhe lopëve të familjes dhe, në fund, nuk bënte dallim midis gjinive, u kërcente aty ku kishte mundësi. Madje filloi të na ndiqte edhe neve, çobanëve. Pas kësaj e refuzuan punën duke kërkuar ta lagonin murroin tarak të Hajdinit. Daja the se e bëjnë një zgjidhje dhe e dërguan te një "veteriner", pa një ditë shkollë (si disa politikanë në Kosovë) i cili, ia shtypi koç... me mjete mekanike duke e tredhur. Nga perspektiva e ditëve të sotme e kuptoj tredhjen si mjet për disiplinim, atëherë e disiplinuan tarakun murroi të Hajdinit sikur që ndërkombëtarët i tredhën disa politikanë tereq të Kosovës. Pasi u kthye, si pjesë e kopesë ish-taraku murroi i Hajdinit, të shkaktonte situata trishtimi, ishte në depresion, nuk ecte, me një fjalë na shkaktonte shumë probleme në fushën e logistikës prandaj, disa çobanë shkuam te dajat me kërkësë që, së paku, t'ia kthejnë një koç.. ish tarakut murroi të Hajdinit e që do ta fitonte statusin e gjysmëtarakut do të ishte zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët... Dajat na thanë se është e pamundur, por se ka mundësi që pas disa viteve t'i dalin do koç... të tjera. Me këtë domin të fitonin kohë, sikur në këto bisedimet e Lajçakut. Vërtet, pas disa vjetëve pati zhvillime, ish kau murroi tarak i Hajdinit përfundoi si rripi mishit të terur apo eshtë me mish që përfundonin në vegsh ku zihej fasule. Ne, çobanët, nuk u ndamë aspak keq!

Tarakizmi politik i Albin Kurtit: Edhe Albin Kurti hyri në politikë si tarak, me tendencë të bëhet kryetaraku i politikës së Kosovës për fillim e pastaj taraku suprem i të gjithë shqiptarëve. Fillimin e kishte të mbarë, vërtet ishte tarak. Në protestat studentore kur filloi "the final Countdown" për lirimin e objekteve universitare, Albini ishte i pathyeshëm edhe kur inspektorët serbë, në krye me Kovaçin sillnin mbi të me tërë fuqinë që e kishin. Pastaj angazhimi i tij në Partinë Parlamentare ishte i jashtëzakonshëm sikur edhe pranimi që të bëhet sekretar-shek i Zyrës së Përfaqësuesit Politik të UÇK-së në Prishtinë e

që drejtohej nga Baca Adem Demaçi. Ishte vendim me shumë rreziqe. Albin Kurti, për dallim nga disa ish-liderë studentorë që sot po i llaskucaven nëpër studiot televizive, duke bërë tifo elektorale, në ndërkohë që tërë karrierën e kanë mbindërtuar me ndihmën e PDK-së dhe Hashim Thaçit të cilin sot e shajnë, në atë kohë i mbeti besnik Bacës Adem. Vetëm Muhamet Mavraj kishte qëndrim korrekt. Albin Kurti e ka shoqëruar Bacën Adem në të gjitha vizitat në zonat e luftës ku, diku e kanë pranuar, diku e kanë refuzuar sikur që ka qenë i pranishëm në takimin kualifikues për Rambuje midis Robin Kukut dhe Bacës Adem Demaçi në Shkup. Nuk është e vërtetë se Albini i është dorëzuar policisë serbe për ta shpëtuar bythën, por është arrestuar me tërë familjen, vetëm nëna e tij, Arifja, ka qenë e lirë. Në burgun e Lipjanit e kanë rrahu aq shumë saqë pa ndjenja e kanë dërguar në burgun e Pozharevcit ku mbahet mend qëndrimi i tij antologjik në përballje me ministrin e Drejtësisë së Serbisë, i kontrabanduar si gazetar. Pas lirimit nga burgu, piarin ia ka bërë Baca Adem Demaçi dhe Albini ka vazhduar maratonën e kundërshtimit të çdo procesi që e ka vlerësuar se është i dëmshëm për Kosovën. Dhe nuk ka arritur ta pengojë asnjë proces. Golgota e tij ka vazhduar me polinë e UNMIK-ut, EULESH-it dhe një pjesë të Policisë së Kosovës që kanë "lénurur lesh në Albinin dhe LV-në", me apo pa asnjë arsy. Me kalimin e kohës Albin Kurti, në përpjekje të ndërtimit të identitetit të vet dhe karizmës personale, është përpjekur të shkelë mbi diçka të shenjtë, mbi krijuesin dhe, siç thoshte, babanë politik, Bacën Adem Demaçi. Albini, si tarak politik, i ka akuzuar të gjithë politikanët e vendit se i ka zënë bakllavaja derisa edhe vetë ka rënë në bakllavanë e Florin Kelmendit, tutorit që ia financoi, me kushte, zgjedhjet e para ku erdhë edhe te ndarja e Bacës, me Albinin. Dhe kur një pjesë e idealistëve, heshtur u larguan nga përkrahja e LV-së, isha edhe unë, pa e dëmtuar publikisht, pasioni i Albinit për pushtet shkoi deri në grykësi. Tarakizmin politik të Albini fillimisht ia ka zbutur pak Florin Kelmendi për të vazhduar me Devollët dhe tash, duket se darët që ia mbajnë koç.. e Albinit, të shtrënguara apo të liruara, po i mban Ekrem Lluka. Albini e pati pushtetin vetëm 52 ditë dhe vetë e rrëzoji veten, jo se e rrëzuan të tjerët. Tash po synon pushtet absolut, me një xhuruldi kandidatësh për deputetë, në mesin e të cilëve ka shumë të mirë, por ka të tillë që as "qeni nuk i hanë" dhe që, nëse nuk bën ndryshime rrënjosore, jo që do ta humbë primatin e tarakut politik, por do të shndërrrohet në një eunuh politik! Albini nuk e ka një të kaluar prej së cilës duhet të turpërohet, përkundrazi, prandaj nuk e kupto pse, duke fshirë deklaratat nga e kaluara për personalitetet apo proceset politike, dëshiron të distancohet nga ajo e kaluar. Natyrisht, politikani i mirë nuk ikën nga e kaluara, por e pranon se ka gabuar në të kaluarën. Ky është testi kur një politikan e pranon sinqerisht se mendon ndryshe dhe se është për bashkëpunim me të gjithë ata që e duan këtë vend dhe se dashuria për vendin dhe kombin nuk duhet të jenë të formatizuara vetëm sipas pikëpamjes së LV-së. Deklarata për Ambasadën e Kosovës në Jerusalem apo rishikimin e marrëveshjeve të nënshkruara, në Bruksel apo Washington, i shkaktojnë dëme edhe LV-së, edhe Albinit si dhe Kosovës. Vardisja e Albinit dhe LV-së, Miroslav Lajçakut dhe BE-së, është një blof apo fluskë sapuni aq më parë që asnjë zgjidhje për Kosovën nuk mund të bëhet pa përkrahjen e ShBA-së. Nëse Albini këmbëngul në këtë që po e deklaron, atëherë qartazi e tregon se nuk ka gatishmëri për të qeverisur dhe për të marrë përgjegjësi. Mendoj se Albin Kurti do të jetë bashkëpunues, në radhë të parë me subjektet politike të Kosovës, pastaj edhe me ndërkombëtarët, në të kundërtën e pret fati i kaut murroi e tarak të Hajdinit, do të tredhet politikisht, për të mos e rikthyer kurrë më potencën politike. Këtë as Albinit e askuq tjetër nuk ia dëshiroj, në asnjë mënyrë. Nëse kjo, megjithatë, do të jetë zgjedhje e vet Albinit, ia paftë hairin! Vetëm i kastruar politikisht mund të bëhet Fidel Castro i Kosovës!

Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale shënon rritje për 4.63 për qind

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" për tremujorin e katërt (TM4 2020) (2015 =100).

ASK-ja ka bërë ndërimin e vitit bazë të indeksit nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit. Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Prodhimet, të cilat krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore, janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe

pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale", është thënë në njoftimin e ASK-së, duke u shtuar se në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. "Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësh, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë. Në tremujorin e katërt të vitit 2020, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 4.63 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 9.25 për qind. Ndërkëq, indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 6.70 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019", është thënë në njoftimin e ASK-së.



ATK-ja tejkalon planin e të hyrave për muajin janar, mbledh 4 milionë euro më shumë

PRISHTINË, 5 SHKURT - Të hyrat në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për muajin janar kanë shënuar performancë të mirë, duke tejkuar pritshmëritë e planikuara. ATK-ja ka njoftuar se gjatë muajit janar kanë realizuar mbi 64 milionë të hyra, apo rreth 4 milionë më shumë sesa në

muajin e njëjtë të vitit 2020. "Për muajin e parë të këtij viti janë mbledhur 64.04 milionë euro, që në krahasim me planin kemi rreth 4 milionë euro të mbledhura më shumë. Trendi i arritur për këtë muaj tregon një nismë të mirë të punës së ATK-së, e cila patjetër se do të ketë reflektim edhe në aktivitete të

tjera, të cilat në vitin 2020, për shkak të pandemisë, janë zhvilluar brenda mundësive. ATK-ja është në fazën e finalizimit të dokumenteve strategjike të cilat do t'i përcaktojnë objektivat dhe aktivitetet e tjera për këtë vit dhe vitet në vazhdim", ka njoftuar ATK-ja.

30 gra në Prizren do të përfitojnë subvencione për bizneset e tyre

PRIZREN, 5 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me Shqipe Breznicën nga organizata gjermane "Help" në Kosovë, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, përmes së cilës 30 biznese të udhëhequra nga gratë në Prizren që operojnë në fushën e eficiencës së energjisë, do të përfitojnë subvencione me qëllim të përforscimit të biznesit të tyre.

Me këtë rast, kryetari Haskuka ka theksuar se në kuadër të projektit të paktën 30 biznese do të mbështeten për të filluar ose zhvilluar bizneset e tyre ku do të përfitojnë: donacion për

pajisje me vlerë mesatare prej 2,649.00 eurosh, organizimi i biznesit dhe trajnimet profesionale sipas nevojave të klientit, si dhe do të bëhet monitorimi i bizneseve të mbështetura.

Po ashtu, kryetari Haskuka ka dekluaruar se, përvèç fuqizimit të grave të qytetit tonë, ky projekt do të ketë ndikime pozitive edhe në zvogëlimin e kërkesës për energji elektrike, rritjen e konkurrencës së tregut të shërbimeve energjetike të Kosovës, duke e nxitur rritjen e vetëdijes së pronarëve të shtëpive private dhe banesave, ku do të zbatohen masat e eficiencës energetike.



Komuna e Gjilanit bën thirrje për respektim të masave kundër Covidit

GJILAN, 5 SHKURT (ER) - Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, nën udhëheqjen e nënkyetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin të premten për vlerësimin e situatës në dy ditët e fundit.

Nënkyetari Ismajli ka thënë se rënia e numrit të rasteve aktive nuk lejon komoditet, pasi virusi është në mesin tonë.

Në emër të komitetit, Ismajli u ka bërë thirrje qytetarëve dhe

bizneseve që japid shërbime, t'u përbahen rrugullave kundër përhapjes së virusit, mbajtjen e maskës dhe mosgrumbullimin e njërvëze. Gjendja e përgjithshme në Gjilan është si vijon: nga 9 629 mostra, 3 467 kanë rezultuar pozitivë, 3 258 janë shëruar, 107 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 108 raste janë aktive, të hospitalizuar dhe të konfirmuar me Covid-19 janë 23 persona dhe 155 mostra në pritej për rezultat.



QKMF-ja hap ordinancë të veçantë për ofrimin e shërbimeve stomatologjike për fëmijë



MITROVICË, 5 SHKURT (ER) - Sektori i Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Nexhat Çuni" gjithmonë ka dhënë shërbime cilësore për fëmijët e Mitrovicës, por që nga fillimi i muajit shkurt ky sektor ka hapur ordinancën e veçantë, ku është furnizuar me një

karrige të re stomatologjike për ofrimin e shërbimeve të duhura vetëm për fëmijët. Ekipet e QKMF-së po vazhdojnë të kryejnë vizita sistematike të shëndetit oral në të gjitha shkollat e Komunës së Mitrovicës. Dhe në terren do të caktohen terminë për realizimin e vizitave në

ordinancën e veçantë stomatologjike. Në kuadër të kësaj ordinancë janë të angazhuar dy specialistë pedodontë, të cilët do të bëjnë trajtimin e pacientëve tanë të vegjël dhe të jepin këshilla për rëndësinë dhe përkujdesjen ndaj shëndetit oral.

Dezinfektohet objekti i Komunës së Drenasit

DRENAS, 5 SHKURT (ER) - Komuna e Drenasit për të ofruar shërbime të sigura për qytetarët në këtë kohë të pandemisë po vazhdon të përkujdeset që ambientet të dezinfektohen rrugullisht. Kompania "Professional Cleaning sh.p.k" në mënyrë vullnetare ka kryer dezinfektimin e tërë hapësirave të objektit të

komunës, duke u përkujdesur kështu që të jetë një vend i pastër jo vetëm për zyrtarët, por edhe për qytetarët që marrin shërbime. Komuna e Drenasit ka falënderuar kompaninë "Professional Cleaning sh.p.k", duke u bërë thirrje qytetarëve të vazhdojnë t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore.



Bulliqi ia dorëzoi 650 ekzemplarë librave bibliotekës së qytetit

PODUJEVË, 5 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtëm Bulliqi, bashkë me drejtorin e Arsimit, Avni Fetahu dhe drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Elhame Kutllovci, ka vizituar bibliotekën e qytetit, me ç'rast i ka dorëzuar 650 ekzemplarë me dhjetëra tituj librash.

Gjatë vizitës së sotme kryetari Bulliqi ka parë nga afër kushtet që ofron biblioteka e qytetit për lexuesit. Me këtë rast, kryetari Bulliqi ka thënë se Komuna e Podujevës është duke investuar në krijimin e kushteve më të mira është rritur edhe numri i lexuesve. Në kuadër të investimeve për pasurimin e fondit të librave, kryetari Bulliqi bashkë me drejtorët Fetahu dhe Kutllovci, i kanë dorëzuar bibliotekës një fond prej 650 librash, të siguruara përmes Drejtorisë së Arsimit.



IZRAELI DHE KOSOVA, NGA MIQËSIA TRADICIONALE, NË ZGJERIMIN E MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE

Marrëdhëniet diplomatike në mes të shteteve, përpos karakterit politik e protokollar, kanë në vjetvete edhe segmentin e besimit të ndërsjellë. Izraeli, duke e njojur pavarësinë e shtetit të Kosovës, beson në miqësinë tradicionale dhe në këmbim të kësaj investon ide e projekte që do ta bënin këtë miqësi jo vetëm pjesë e rrëfimeve dhe kujtimeve të mbijetuarve të Holokaustit, ku shqiptarët luajtën një rol vendimtar për shpëtimin e qindra hebrenjve gjatë LDB-së, por edhe preokupim i pashmangshëm për ngritjen e kapaciteteve shtetndërtuese e zhvillimore të Kosovës, tash e në të ardhmen



Nga Mehmet PRISHTINA

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes të Izraelit dhe Kosovës është lajmi më i mirë i këtij fillimviti. Ky akt shënon një epokë të re në politikën e jashtme të Kosovës jo vetëm përfaktin se edhe kësaj radhe ishte ShBA-ja sponsorja kryesore e kësaj ngjarjeje me karakter ndërkombëtar, por edhe përsyjet që lidhen me prishjen e mitit se gioja Izraeli asnjëherë nuk do ta njojhë pavarësinë e Kosovës ashtu siç kishin trumbetuar disa megafonë të ndryshkura në Beograd.

Ndonëse Bashkimi Evropian s'i ka pëlqyer zyrtarizimi i vendimit të Kosovës përfatësuar, duke iktuar se Kosova është një shtet i cili përfundon marrëdhëniet e reja të ndërmjet Kosovës dhe Izraelit, duke shkruar se: "Lidhjet më të thella ndërkombëtare ndihmojnë më tej paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe Lindjen e Mesme".

Edhe ish-kongresisti amerikan dhe mik i madh i shqiptarëve, Eliot Engel, ka thënë se dita e vendosjes së raporteve diplomatike në mes të shtetit të Izraelit dhe Republikës së Kosovës është një ditë e madhe përfatësuar.

"Urimet e mia që deri më tanë nuk e kanë njojur Kosovën shtet. Brukseli

zyrtar nuk ka qenë gjithaq i angazhuar në këtë drejtëm dhe

politika e jashtme e BE-së

Kosovë e ka trajtuar më tepër si

një hapësirë gjeopolitike sesa

një entitet i pavarur shtetëror.

Kjo politikë ka prodhuar standarde të dyfishta në rapport

me Kosovën dhe Serbinë, ku kjo

e fundit gjithmonë është trajtuar

si një fëmijë i lazduar të cilët

duhet t'i jepen të gjitha lodrat që

i kërkon.

Prandaj na duket e dorës së dytë

çështja se në cilin qytet të Izraelit

do të jetë në të ardhmen

ambasada e Kosovës, me krasim me rëndësinë që ka përfunduar Kosovës njohja si shtet i pavarur nga një vend i rëndësishëm siç është Izraeli. Fundja edhe shqetësimi që vjen nga Beogradit nuk lidhet gjithaq me atë se ku do të jetë në të ardhmen ambasada e Kosovës - në Jerusalem apo në Tel Aviv. Ky shqetësim ka të bëjë më tepër me faktin se subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës po fuqizohet gjithnjë e më tepër dëshiron po ndodh me mbështetje të drejtëpërdrejtë amerikane.

Mbi rëndësinë e këtij akti, flet edhe deklarata e zëdhënësit të Departamentit të Shtetit Amerikan, Ned Price, i cili përshëndeti marrëdhëniet e reja të ndërmjet Kosovës dhe Izraelit, duke shkruar se: "Lidhjet më të thella ndërkombëtare ndihmojnë më tej paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe Lindjen e Mesme".

Edhe ish-kongresisti amerikan dhe mik i madh i shqiptarëve, Eliot Engel, ka thënë se dita e vendosjes së raporteve diplomatike në mes të shtetit të Izraelit dhe Republikës së Kosovës është një ditë e madhe përfatësuar.

"Urimet e mia që deri më tanë nuk e kanë njojur Kosovën shtet. Brukseli

zyrtar nuk ka qenë gjithaq i angazhuar në këtë drejtëm dhe

politika e jashtme e BE-së

Kosovë e ka trajtuar më tepër si

një hapësirë gjeopolitike sesa

një entitet i pavarur shtetëror.

Kjo politikë ka prodhuar standarde të dyfishta në rapport

me Kosovën dhe Serbinë, ku kjo

e fundit gjithmonë është trajtuar

si një fëmijë i lazduar të cilët

duhet t'i jepen të gjitha lodrat që

i kërkon.

Prandaj na duket e dorës së dytë

çështja se në cilin qytet të Izraelit

do të jetë në të ardhmen

1947) e cila bëri thirrje që Jerusalemi 'të vendoset si një korpus separatum nën një regjim të veçantë ndërkombëtar... të administruar nga Kombet e Bashkuara'.

Propaganda e ditëve të fundit që po orkestrohet nga qarqet serbe e ruse, ka për qëllim të relativizojë peshën dhe rëndësinë e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në mes të Izraelit dhe Kosovës, duke nxitur me këtë rast disa shtete arabe dhe disa të tjera që të kundërshtojnë këtë akt.

Ministri i Jashtëm serb, Nikola Selakoviq, tha më 2 shkurt se ky hap do të "ndikojë në marrëdhëniet Serbi - Izrael". "Izraeli vetë zgjodhi se interesin më të rëndësishëm e ka lidhjen me Amerikën dhe ajo që është e rëndësishme për Amerikën sesa Serbia është e drejta e tyre legjitime. Ajo që është e rëndësishme është që ne nuk morëm pjesë në atë proces sepse presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, nuk pranoi (në Uashington) të nënshkruajë ftesën për Izraelin për të njojur të ashtuquajturën Kosovë dhe anasjelltas", i tha Selakoviq Radio Televizionit të Serbisë (RTS), duke theksuar se nuk ishte as i lumenjtur e as i kënaqur me marrëdhëniet e sapokrujuara midis dy vendet.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, reagoi në mënyrë të ngjashme më 1 shkurt, duke thënë se ky vendim nuk do të ketë efekt pozitiv në marrëdhëniet mes shtetit të tij dhe Izraelit. Prandaj është me shumë rëndësi që opinioni publik të mos ndikohet nga kjo propagandë dhe më së paku të bëhet temë

debatit se ku do të ndodhet përfaqësia diplomatike e Kosovës në Izrael. Madje ka plot shtete në botë që nuk kanë gjithkund ambasadë, mirëpo kjo nuk i pengon ato që të zhvillojnë marrëdhënie solide diplomatike e bilaterale në të gjitha fushat.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Izraelit nuk shënon vetëm një akt protokollar ceremonial, por më tepër se kaq. Për Kosovën, Izraeli paraqet një prej partnerëve më të rëndësishëm në fuqizimin dhe thellimin e lidhjeve miqësore tradicionale në mes të popullit hebre dhe atij shqiptar. Mbi këtë parim duhet parë edhe të ardhmen e marrëdhënieve në mes të këtyre dy shteteve, duke listuar një varg prioritetesh që ndërlidhen me zhvillimin dhe progresin, sidomos të Kosovës, e cila ka nevojë shumë përvojat e shtetit të Izraelit në disa fusha, siç janë agrobiznesi, shëndetësia, teknologjia informative etj.

Marrëdhëniet diplomatike në mes të shteteve, përpos karakterit politik e protokollar, kanë në vjetvete edhe segmente të besimit të ndërsjellë. Izraeli duke e njojur pavarësinë e shtetit të Kosovës, beson në miqësinë tradicionale dhe në këmbim të kësaj investon ide e projekte që do ta bënin këtë miqësi, jo vetëm pjesë e rrëfimeve e kujtimeve të mbijetuarve të Holokaustit, ku shqiptarët luajtën një rol vendimtar përfatësuar, duke iktuar se qindra hebrenjve gjatë LDB-së, por edhe preokupim i pashmangshëm përfatësuar i marrëdhënieve së shtetndërtuese e zhvillimore të Kosovës, tash e në të ardhmen.



Kastriot Jupa dhe Albina Rugova, më të mirët e vitit 2020

PRISHTINË, 5 SHKURT - Të premtën në "Sheshin 21" në Prishtinë është mbajtur manifestimi "Laureatët e Vitit 2020". Federata e Hendballit e Kosovës ka shpallur më të mirët e vinit të kaluar, që ishte i vështirë për shkak të pandemisë, por edhe i suksesshëm për hendballin e Kosovës. Çmimet kryesore i kanë fituar Kastriot Jupa dhe Albina Rugova. Pivoti i Besa Famgas dhe i Përfaqësueses së Kosovës, Jupa, për herë të gjashtë është shpallur hendballisti më i mirë i vinit në Kosovë. Ndërkorë aloja e Istogut dhe e Kombëtares së Kosovës, Albina Rugova, është shpallur hendballistja më e mirë e vinit 2020. Jupa natyrish ka zënë vend edhe në përbërjen më të mirë të vinit 2020, ku bëjnë pjesë edhe Mursel Mehmeti (Besa Famgas – portieri më i mirë), Lulzim Shabani (Prishtina – aloja e majtë më e mirë), Deniz Terziqi (Prishtina – fundori i majtë më i mirë), Egzon Gjuka (Besa Famgas – qendra më e mirë), Beni Sula (Prishtina – fundori i djathtë më i mirë), Drilon Tahirukaj (Besa

Famgas – aloja e djathëtë më e mirë). Bujar Ramosaj (Besa Famgas) është shpallur sërisht lojtari më i mirë në mbrojtje për vitin 2020, ndërsa golashënuesi më i mirë për vitin 2020 ishte Arjanit Hoxha i Llapit me 169 gola. Çmimi i hendballistikët më të mirë të Kombëtares së Kosovës i ka takuar Luigj Qunit, anëtarit të Amicitia Zurich.

Te hendballistet, në përbërjen më të mirë të vitit 2020 kanë zënë vend: Njomza Kelmendi (Vushtria – portierja më e mirë), Albina Rugova (Istogu – aloja e majtë më e mirë), Burneta Rama (Vushtria – fundorja e majtë më e mirë), Puhiza Gashi (Kastrioti – qendra më e mirë), Suzana Ujkiq (Istogu – pivotja më e mirë), Shpresa Fazlija (Shqiponja – fundorja e djathëtë më e mirë), Albulena Kelmendi (Ferizaj – aloja e djathëtë më e mirë). Shkurti Mehmeti (Prishtina) është hendballistja më e mirë në mbrojtje për vitin 2020, ndërsa Albina Rugova është edhe golashënuesa më e mirë e vitit 2020 me 162 gola. Hendballistja



më e mirë e Përfaqësueses së Kosovës është shpallur Marigona Hajdari e skuadrës daneze Ringkobing. Klubet kampione, KHF Ferizaj e KH Besa Famgas janë shpallur klubet më të suksesshme të vitit 2020. Të kadetet KHF Samadrexhës i takuar çmimi “klubi më i suksesshëm i vitit”, ndërsa KHF Prishtinës te kadetët. KHF Istogut dhe KH Besa Famgas

u kanë takuar mirënjohje të veçanta "për suksesin e arritur në garat evropiane". FHK-ja ka ndarë edhe mirënjohje e çmime të tjera. Mirënjohjet post-mortem për kontributin e dhënë në hembollin e Kosovës për dekada u kanë takuar Afrim Qorollit, Daver Haskukës, Sami Mustafës, Shaban Demirit dhe Bashkim Hoxhës. Prej gazetarëve janë ndarë mirënjohje për RTV

21, Grupin KOHA, Klan Kosovën, Radio Kosovën, ShGSK-në dhe Kemajl Gocën. Për kontribut dhe bashkëpunim me FHK-në gjatë vitit 2020, mirënjohje i është dhënë Departamentit të Sportit të MKRS-së. Në konkurrencën e kadeteve më të dalluarat u shpallën: Arjeta Maloku (Samadrexha), Blenarda Bytyqi (Istogu), Diarta Shala (Prishtina), Elda Hoxha (Kastrioti), Mirjeta Dinolli (Ferizaj). Te kadetët më të dalluarit ishin: Dardan Ramadani (Prishtina), Jon Vokshi (Besa Famgas), Amir Fazliu (Vushtrria), Ermir Smaka (Trepça), Betim Idrizi (Vëllaznimi). Çmimi i punëtorit sportiv të vitit 2020 u është ndarë Fikret Sadikut e Tefik Retkocerit, kurse mirënjohje për vepër jetësore kanë pranuar Rifat Shabani, Ferat Basholli e Ismet Jupa. Ilir Bytyqi e Syart Kasapi janë shpallur gjyqtarët më të suksesshëm të vitit 2020, kurse çmimi i trajnerit më të suksesshëm të vitit 2020 i ka takuar spanjollit të Besa Famgas, Javier Cabanas.

KOK-i i rekomandon MKRS-së që kategorizimi i sporteve të bëhet me pikët e fituara nga rezultatet e vitit 2019

PRISHTINË, 5 SHKURT - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës ka aprovuar raportin e Komisionit për Kategorizimin e Sporteve, Sportistëve dhe Trajnerëve të cilët kanë dalë me rekomandim që shkaku i vështirësive të krijuara nga pandemia Covid-19, rezultatet dhe aktivitetet e federatave sportive të vitit 2020 të mos merren parasysh. Me këtë rast, BE i KOK-ut i ka rekomanduar ministres për Kulturë, Rini e Sport, Vlora Dumoshi, që kategorizimi i sporteve për vitin 2021 të bëhet me pikët e fituara nga rezultatet dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2019. Komisioni ka analizuar gjendjen e krijuar në sportin e Kosovës për vitin 2020, ku kishte ardhur në përfundim që shumica e federatave sportive nuk kanë arritur ta realizojnë kalendarin e tyre të aktiviteteve si dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare shkaku i pandemisë Covid-19.

Për federatat e reja sportive, të cilat nuk janë kategorizuar në vitin 2020 dhe të cilat kanë aplikuar për kategorizim në vitin 2021, Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, bazuar në rekomandimin e komisionit, i ka rekomanduar MKRS-së që t'u



ndajë buxhet në bazë të nenit 6 të Rregullores për Kategorizimin e Sporteve, kriteri statusi i sportit, e që nënkupton se federatat olimpike t'i kenë 27 pikë, federatat joolimpike 17 pikë dhe federatat që janë anëtarë të GAISF 11 pikë, si dhe federatat e tjera 5 pikë. Për shkak se numri i pikëve në kategorinë e fundit është shumë i vogël, KOK-u ka rekomanduar MKRS-në, që federatave të dy kategorive të fundit t'u ndajë minimum 10 mijë euro, me qëllim

të realizimit të aktiviteteve të tyre sipas kalendarit vjetor. Federatat e pakategorizuara në vitin paraprak dhe vlerësimi sipas nenit 6 të Rregullores për Kategorizimin e Sporteve, Sportistëve dhe Trajnerëve. Në kategorizimin e sportistëve, ndodhen 21 sportistë të gjashtë sporteve të ndryshme. Edhe këtë herë prin sporti i xhudos, në të cilin kategorizohen nëntë xhudistë. Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Loriana Kuka

Federatat olimpike		Federata e Njohurave nga GAISF		
Federata e Kajakimit të Kosovës	27 pikë	Egzon Shala Patriot Behrami Fortesa Orana		
Federata e Gofit të Kosovës	27	Albulena Gërvalla Elhami Shabani Vesa Ibrahimimi		
Federata Jo-olimpike		Benjamin Shabani Betim Maliqi Dren Ibrahimimi		
Federata e Motociklizmit të Kosovës	11 pikë	Elhami Shabani Vesa Ibrahimimi Benjamin Shabani		
Federata e Biliardos së Kosovës	11 pikë	Betim Maliqi Dren Ibrahimimi Muhamet Ramadani		
Federata e Pikados së Kosovës		Kushtrim Bajraktaraj		
Federata tjetra		Granit Kuleta		
Federata e Arteve Marciale e Kosovës	5 pikë	Kategorizimi i trajnerëve		
Federata e E-sporteve të Kosovës	5			
Kategorizimi i sportistëve		PIKE		
Majlinda Kelmendi	(xhudo)	Driton Kuka	(xhudo)	172.5
Distria Krasniqi	(xhudo)	Shqipe Zogjani	(karate)	25
Loriana Kuka	(xhudo)	Sylejman Shala	(mundje)	17.5
Nora Gjakova	(xhudo)	Besim Brahimë	(boks)	12.5
Akil Gjakova	(xhudo)	Isak Curri	(karate)	10
Laura Faziliu	(xhudo)	Blerim Hajdari	(karate)	10
Flaka Loxha	(xhudo)	Shaban Ramadani	(atletikë)	10
Erza Muminovic	(xhudo)	Sabri Dragusha	(bodybuilding)	8.75
Fatjona Kasapi	(xhudo)	Agron Tosuni	(karate)	5.75
		Esat Lata	Bodybuilding	5
		Fidair Berisha	Karate	3.125

Lazio mohon mosmarrëveshjet me Strakoshën, konfirmon lëndimin e tij

ROMË, 5 SHKURT - Thomas Strakosha ditët e fundit është përfolur shumë në lidhje me situatën e tij. Lazio, ndër kohë, nuk ka humbur kohë për të sqaruar se portieri shqiptar vuan nga një dëmtim. Klubi "bardhekaltër" përgjënjeshtron

lajmet për krisje me lojtarin dhe thekson edhe një herë dëmtimin e tij, teksa shton se nuk ka qenë nevoja e operacionit. "Në lidhje me disa lajme që u publikuan në gazetat e sotme, thekojmë se Thomas Strakosha ditët e fundit ka pasur një traumë në gjirin e tij të djathtë. Aktualisht, ekzaminimet kanë përfashtuar nevojnë për operacion dhe lojtar po kalon një trajtim rehabilitues konservativ. Portier 'bardhekaltër' po monitorohet çdo ditë për ta vlerësuar kohën e rifillimit të aktivitetit. Lajmet përkthyes janë pa baza.

Eziston një marrëdhënie respektive reciprok dhe besimi absolut midis lojtarit dhe klubit, falë profesionalizmit që ai ka treguar gjithmonë në qëndrimin e tij të gjatë në klub", shkruhet në reagimin e Lazios.



Vazhdon shkëlqimi i Zérina Shattrit, nderohet nga ekipi amerikan

PRISHTINË, 5 SHKURT - Ekipi i basketbolit për femra Saints (OLLU) mposhti Jarvis Christian College (JCC) 101-91 dhe përmirësohet në 2-3 në përgjithësi në Konferencën Atletike të Red River (RRAC). Në këtë ndeshje Santa ka nderuar basketbollisten nga Istogu, Zérina Shatri. Basketbollistja nga Kosova edhe kësaj radhe ka qenë ndër më të mirat për ekipin amerikan. Shatri udhëhoqi Saints në shënimin e 22 pikëve, e ndjekur nga Cormia Lewis me 20 pikë, Tiffany Lopez (SO / San Antonio, Texas) me 18 dhe Angeline Sanchez (SO / Cibolo, Texas) me 17. Shatri dhe Lopezi kryesuan ekipin me nëntë kërcime secila. Trajnerja Stacy Stephens e ka lavdëruar Zérinën, por punën e saj të madhe që bën në parket, por duke marrë edhe si shembull angazhimin brenda dhe jashtë fushës. "Ishte ndeshja e fundit në shtëpi, andaj ishte një ndeshje speciale", ka thënë Zérina, e cila nuk ishte në



djeni se familja e saj nga Kosova i ka dërguar një mesazh. "Nuk e dija këtë. Më kanë munguar në çdo ndeshje. Nuk ka qenë e lehtë përmua, por duke e ditur se më shikojnë në çdo ndeshje, më

ka dhënë motiv përmirësuar. Kam pasur një përvjetor të paharrueshme këtu. Kam përparuar shumë këtu. Kam mësuar gjëra të reja, si në parket, por edhe në jetë", ka thënë Shatri.

Drita fiton Kupën e Ligës së Parë

SUHAREKË, 5 SHKURT - RC Cola Drita ka fituar Kupën e Ligës së Parë, duke mundur AS Prishtinën 75:67 (11:13, 25:19, 15:24, 24:11), në finale të Kupës të kësaj kategorie. Çereku i parë ishte i baraspeshuar dhe këtë edhe rezultati i kësaj pjese, 11:13. Sidoqoftë, gjilanasiit në periudhën e dyte

ishin më të mirë duke e fituar këtë pjesë 25:19, duke përfunduar pjesën e parë në të mirë të tyre 36:32. Megjithatë, prishtinasit rikthehen shpejt dhe këndellen në periodën e tretë, duke barazuar shifrat e kaluar në epërsi 51:56. 10 minutat ishin mjaft interesante.

Rikthehen sërisht dhe ishin më të mirë në periudhën e fundit, duke e fituar 24:11, përmirësuar në fund 75:67. Te Drita u dallua Xzavier Bramore me 25 pikë e shtatë kërcime dhe Bardhe Jakupi me 16 pikë, kurse te AS Prishtina u dalluan Ermir Gashi me 21 pikë e 17 kërcime dhe Albatrith Berisha me 17 pikë.

Skitarët e Kosovës udhëtojnë në Itali për Kampionatin Botëror

PRISHTINË, 5 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në skitari ka udhëtar drejt Cortina d'Ampezzo të Italisë, ku nga 8 deri më 21 shkurt do të mbahet Kampionati Botëror i Skitarisë. Kosovën në këtë garë do ta përfaqësojnë skitarët Arbi Pupovci, Albin Tahiri dhe Fiona Rusta-Blaka, të cilët janë edhe bursistë të Komitetit Olimpik të Kosovës për Lojërat Olimpike Dimërore Pekin 2022. Bashkë me ekipin kanë udhëtar edhe trajnerët Agim Pupovci përmes meshkujt dhe Bujar Turjaka përmes femrat, si dhe doktori Shyqi Memë.



SHKURT

Marku: Kini besim të plotë tek unë, do të luftoj përmirësuar kuq e zi

Florian Marku së fundmi ka treguar në një postim se përfaqëson ngjyrat kuq e zi me krenari në botë. Marku është në përgatitje e sipër pasi ka një meç përmirësuar me Rylan Charlton, më 20 shkurt në "Wembley" të Londrës. Së fundmi ai ka postuar një foto në llogarinë e tij "Facebook" duke falënderuar gjithë njerëzit që i kanë dërguar mesazhe pozitive. "Ju përshtendes të gjithëve dhe faleminderit përmirësuar gjithë mesazhet që më keni dërguar dhe më dërgoni vazhdimish", ka thënë ai. Më tutje, Marku tregon se ai lufton përmirësuar, përfunduar. "Data 20 shkurt është sfida më e rëndësishme në karrierën time të boksit. Keni besim të plotë tek unë pasi po përgatitem si kurrë më parë, po pres me padurim", ka përfunduar Marku.

Ndahet ngajeta legjenda e basketbollit shqiptar, Arben Fagu

Të premten në mëngjes ka ndërruar jetë në moshën 65-vjeçare ish-basketbollisti i kombëtares, Arben Fagu. Lajmin e hidhur e bën me dije ekipi i basketbollit Tirana Eagles Basket dhe miq të tij. Arsyja e vdekjes së parakohshme të legjendës së basketbollit mësorët të jetë një sëmundje rëndë, e cila iu shfaq befasishëm dhe në fund Fagu nuk mundi ta mposhtë. Në dhjetor ai iu nënshtrua një operacioni shumë të vështirë dhe në atë kohë personat e afërm të tij bënë thirje përmirësuar. Pasi ndërhyrja ishte shumë e vështirë. Në karrierën e tij Fagu ka luajtur më shumë me Partizanin, me të cilin numëron shumë suksese si lojtar, por edhe si trajner i tyre. Fagu ishte gjithashtu profesor në Universitetin e Sporteve në Tiranë.

Reali interesohet përmirësuar për Mahrezin

Real Madridi ka filluar të mendojë edhe përmirësuar për sezonin e ardhshëm. Në listën e transferimeve përmirësuar janë aktívët aktivizohet me Manchester Cityn. 29-vjeçari këtë sezon me fanellën e "Citizens"-it është aktivizuar 15 herë, duke realizuar 5 gola. Spanjollit kërkonin një sulmues përmirësuar repartin e avancuar dhe algerianin duket se është futbollisti ideal për të luajtur përkrah Karim Benzemës. Kontrata e Riyad Mahrezit me klubin anglez skadon në vitin 2023.

Ruiz fiton betejën ndaj Covidit

Trajneri i Napolit, Genaro Gattuso, ka marrë një lajm shumë të mirë vetëm pak ditë para përfalljes ndaj Genoas në Serinë A, por edhe dueleve ndaj Atalantës në Kupën e Italisë dhe Juventusit në javën e 21-të të kampionatit.

Fabian Ruiz, mesfushori spanjoll i Napolit, ka fituar betejën me koronavirusin dhe nga dita e premte me shumë mundësi do t'i bashkohet skuadrës në stërvitje. Këtë lajm e ka publikuar vete klubit napoletan me anë të një komunikate në sajtin e saj zyrtar duke deklaruar se mesfushori spanjoll pas kontrollit të tamponit ka rezultuar negativ me Covid-19.

Ish-sulmuesi i PSG-së: Mbappe dëshiron t'i bashkohet Realit

Kylian Mbappe do të veshë një ditë fanellën e Real Madridit. Të shumtë janë ata që besojnë në këtë "martesë" dhe i fundit që i bashkohet këtij kori është Jese, sulmuesi i majtë spanjoll. 27-vjeçari ka luajtur me yllin francez te PSG-së teksha prej datës 1 shkurt është pjesë e Las Palmasit në La Liga 2. Në një prononcim përmirësuar, lojtari iberik ndalet te sulmuesi francez dhe kalimi i tij i mundshëm te "Los Blancos". Kylian dëshiron me të vërtetë të luajë me Real Madridin. Idhulli i tij ka qenë gjithmonë Cristiano Ronaldo. Ai e dashuron Realin dhe jam i bindur që do të transferohet një ditë në 'Santiago Bernabeu', ka deklaruar sulmuesi spanjoll.



D P A
Departamenti për punë administrative
Department for administrative works
Prishtinë me 05.02.2021 | Nr. 192

U.D. Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale te Ujësjellësit „**Prishtina**“ SH.A. – Prishtinë, në harmoni me nenin 16, pika 11 – 3.2 të Statutit të KUR „Prishtina“ Sh.A., me datën 05.02.2021, merr vendim për shpalje publike:

SHPALLJE PUBLIKE

Për kryerjen e shërbimeve të veçanta në Kompani

1. Një (1) Kontabilist të certifikuar.

I përgjigjet: Menaxherit për Kontabilitet dhe Thesar, ZKF dhe KE-së.

Vendi i Punës: Prishtinë.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtoreve. 900.00 Euro

Kohëzgjatja e kontratës: Maksimalisht 30 ditë.

Orari i punës: I plotë.

Detyrat dhe përgjegjësitet kryesore:

Përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin 2020, rishikimin e tyre, certifikimin dhe nënshkrimin e tyre.

Kushtet:

Për kryerjen e këtyre punëve, përvèç kushteve të përgjithshme, kandidati duhet të ketë:

Përgatitjen Superiore Profesionale – Fakulteti ekonomik; - të jetë kontabilist i certifikuar; - të ketë së paku 5 vite përvjoe pune në lëmine e kontabilitetit.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- diploma e përgatitjes profesionale;
- çertifikatat e kontabilistikit;
- kopja e letërnjofitimit;
- çertifikata e lindjës;
- vërtetimi i përvjoes së punës;

Procedura për aplikim: Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve përsonele dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Shpalljes dhe dërgohen në adresën KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4 në zyrën nr. 44, më së voni deri me **19.02.2021** në ora **16.00**.

Rruja „Hazir Shala“ nr.4, Prishtinë
Tel +381 38 54 12 11, +381 38 55 10 10
Fax +381 38 54 14 37

www.kur-prishtina.com

NJOFTIM MBI ZVOGELIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "ContourGlobal Kosovo" L.L.C

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqerise, të plotësuara dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë "ContourGlobal Kosovo" L.L.C., shoqëri me përgjegjësitet kufizuara, me numër unik identifikues 810093039 ("Shoqëria") ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË me datë 05.02.2021.

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar 28,201,000.00 Euro në 27,951,000.00 Euro, duke 250 aksione.

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"ContourGlobal Kosovo" L.L.C., Anton Çetta 5A, Prishtinë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë

[facebook](#) www.facebook.com/gjejpunespejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

- Arben Rama shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Bujqësisë "Abdyl Frashëri" Prishtinë.
- Shpejtim Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.
- Ardian Pintolli shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Abdyl Frashëri" Prizren.
- Erblind Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Besim Ndrecaj" Lutogllav.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, katë dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira afër "Bill Clintonit", katë tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çimim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L